

VENDIM
Nr. 121, datë 28.10.2013

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 17,
SERIA PV04P, TË SHOQËRISË “MARJAKAJ” SHPK, “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE” NGA HEC “BENE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 43, DATË 14.10.2004**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “a”, 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 10 pika 3, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikave 2.3 dhe 2.4 të “Licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Marjakaj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

Meqenëse në kërkesën e subjektit aplikues për modifikim, saktësimi i parametrave teknikë të skemës së shfrytëzimit energjetik të ujërave të përroit të Benes nuk është dhënë i qartë, do të kërkohet nga ky subjekt, që brenda afatit dymujor të zbatimit të procedurave të ERE-s, të paraqitet në ERE një informacion teknik lidhur me saktësimin e këtyre parametrave.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 17, seria PV04P, të shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Bene”, me fuqi 125 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 43, datë 14.10.2004.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti